

KARTELE INFORMATIVE

AL011057

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, të Patentës për Shpikje			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Pronari i një patente për shpikje mund t'ia kalojë të drejtat e Pronësisë një personi tjetër nëpërmjet një kontrate transferimi pronësie. Kjo Kontratë bëhet e vlefshme pas regjistrimit në DPPI.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	<p>Çdo kontratë për ndryshim pronësie një patente bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët kontraktuese, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.</p> <p>Çdo ndryshim pronësie i një patente kryhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Kalimi i pronësisë së një patente, ndryshimi regjistrohet në regjistrin e patentave. Pronari i patentës ka të drejtë të fillojë një proces gjyqësor për patentën, vetëm nëse ndryshimi i pronësisë është i regjistruar në këtë regjistër. DPPI-ja boton ndryshimet në pronësinë e patentave. Kalimi i pronësisë të patentës ka efekte ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit të kalimit të kësaj pronësie në regjistrin e patentave. Megjithatë, kalimi i pronësisë përpara regjistrimit vlen për palët e treta, të cilat i kanë fituar të drejtat për patentën pas datës së këtij kalimi, edhe pse ishin në dijeni për këtë kalim në datën në të cilën ato i fituan të drejtat.</p>			
4. A jam përfitues?	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka një patentë për shpikje.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formular aplikimi për kërkesë ndryshimi pronari	Aplikanti	Po
	2	Mandat i pagesës së tarifës përkatëse	Bankë	Po
	3	Dokumentin që vërteton ndryshimin e pronarit	Aplikanti	Po
	4	Autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Qyteti Tiranë	Adresa Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	Orari E hënë- e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë 5 000 Lekë	Tarifa shtesë Nuk ka	Tarifa Online Nuk ka	Mënyra e pagesës Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
10. Çfarë përfitoj?	Njoftim			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Akti administrativ është i vlefshëm për aq kohë sa nuk ka një ndryshim pronësie të mëvonshëm.			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në platformën "Shqipëria që duam" <input checked="" type="checkbox"/> Link: www.shqiperiaqeduam.al			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar ; VKM Nr.1707 datë 29.12.2008 për Miratimin e rregullores "Për lëshimin e Patentave për Shpikje dhe Modelet e përdorimit" e ndryshuar VKM Nr.883, datë 13.05.2009 "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale" i ndryshuar			